



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I INVESTIMEVE**

**VENDIM  
NR.1 DATË 01.07.2015  
PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË  
INVESTIMEVE**

Në bazë të nenit 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 294 datë 08.04.2015 “Për Krijimin e Këshillit të Investimeve”, me propozim të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve dhe pasi shqyrtoi projekt dokumentin e propozuar, Këshilli i Investimeve,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Investimeve” teksti i së cilës i është bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretariati i Këshillit të Investimeve për zbatimin e Rregullores.
3. Ky vendim hyn në fuqi nga data 01.07.2015.

---

KRYETARI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

\*\*\*

**KËSHILLI I INVESTIMEVE**

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E**  
**KËSHILLIT TË INVESTIMEVE**

**KAPITULLI I 1**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

*Neni 1*  
*Baza Ligjore e Rregullores*

Rregullorja “Për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Investimeve” bazohet në pikën 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 8.4.2015 “Për Krijimin e Këshillit të Investimeve”.

*Neni 2*  
*Qëllimi*

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë:

- a) Në mënyrë të detajuar rregullat e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Investimeve;
- b) Detyrat, funksionet dhe kompetencat e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve si strukturë organizative dhe ekzekutive brenda Këshillit të Investimeve;
- c) Parimet dhe procedurat, në bazë të të cilave Sekretariati i Këshillit të Investimeve përmbush detyrat, funksionet dhe kompetencat e tij.

*Neni 3*  
*Statusi Juridik i Këshillit të Investimeve*

Këshilli i Investimeve është organ i pavarur këshillimor i Këshillit të Ministrave i drejtuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për të nxitur dialogun ndërmjet shoqatave përfaqësuese të komunitetit të biznesit privat, organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe qeverisë për zhvillimin e një klime biznesi dhe investimesh të favorshme, jo diskriminuese, transparente dhe të ndershme në Shqipëri.

*Neni 4*  
*Emërtimi i Shkurtuar, Logo dhe Vula*

- 4.1 Emërtimi i shkurtuar i Këshillit të Investimeve/Investment Council është përkatësisht KI/IC.
- 4.2 Përmbajtja e Vulës së KI është: Republika e Shqipërisë, Këshilli i Investimeve (KI).

## **KAPITULLI II**

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE**

#### *Neni 5* *Objekti*

5.1 KI ka objekt të veprimtarisë së tij:

- a) Nxitjen e dialogut konstruktiv dhe shkëmbimit të pikëpamjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave, Ministrive dhe Agjencive të tjera ekzekutive në varësi të tyre nga njëra anë dhe sektorit privat nga ana tjetër, në lidhje me përmirësimin dhe inkurajimin e një klime të shëndoshë të investimeve dhe zbatimin e një plani masash efektiv kundër korrupsionit në përputhje me parimet e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Korrupsionit.
- b) Përgatitjen e analizave ligjore, ekonomike dhe rekomandimeve konkrete me fokus përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe hartimin e politikave për nxitjen e investimeve.

5.2 KI nëpërmjet Kryetarit, bazuar në analizat, diskutimet dhe konkluzionet e mbledhjeve periodike të Këshillit të Investimeve, i paraqet rekomandime konkrete Kryeministrit dhe Ministrave përkatës, për të realizuar ndryshimet e nevojshme ligjore apo për të ndërmarrë iniciativa të tjera me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

#### *Neni 6*

##### *Parimet e Funkcionimit dhe Organizimit të Këshillit të Investimeve*

KI organizohet dhe funksionon në përputhje me:

- a) *Parimin e transparencës* duke publikuar në faqen zyrtare në internet çdo vendimmarrje konkrete të KI dhe çdo rekomandim të përcjellë Kryeministrit dhe/ose Ministrave nga KI.
- b) *Parimin e parandalimit të konfliktit të interesit* në çdo vendimmarrje të KI sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar).
- c) *Parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të biznesit*, duke qenë gjithëpërfshirës dhe duke u bërë zëri i këtij të fundit pranë organeve ekzekutive në vend.

#### *Neni 7*

##### *Veprimtaritë e Këshillit të Investimeve*

7.1 Veprimtaritë e Këshillit të Investimeve përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 294 datë 08.04.2015.

7.2 Këshilli i Investimeve për përmbushjen e qëllimit dhe në zbatim të objektit të veprimtarisë së tij monitoron dhe identifikon pengesat kryesore në sektorë të

ndryshëm në fushën e biznesit me qëllim zvogëlimin e pengesave administrative dhe më konkretisht:

- a) I rekomandon Kryeministrit, Ministrave, dhe organeve të tjera të administratës publike propozime të konsoliduara të mbështetura në ekspertizën profesionale ligjore dhe ekonomike të Sekretariatit me qëllim:
    - i) ndryshimin dhe/ose përmirësimin e legjislacionin rregullator për biznesin;
    - ii) ndryshimin dhe/ose zvogëlimin e proceduravë burokratike për hapjen, funksionimin, zhvillimin ose mbylljen e një biznesi.
  - b) Sipas nevojave të punës të KI dhe në përputhje me procedurat e financuesit të Sekretariatit, përfshin specialistë për kryerjen e vlerësimeve për përmirësimin e klimës së biznesit.
  - c) Analizon rastet e praktikave të padrejta dhe abuzive kundër biznesit dhe koordinon procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
  - d) Zhvillon dhe nxit praktikat më të mira për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit për çështje që lidhen me biznesin privat, duke mbështetur njëkohësisht Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Korrupsionit.
- 7.3 Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 7.2 si më sipër, Këshilli i Investimeve ka të drejtë të kryejë dhe të përmbushë çdo detyrë tjetër në përputhje me parashikimet e VKM nr. 294 datë 08.04.2015.

## ***Neni 8*** ***Funksionimi i KI***

- 8.1 Veprimtaria e përditshme e Këshillit të Investimeve koordinohet nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, i cili në veprimtarinë e tij është një strukturë organizative dhe ekzekutive e pavarur dhe politikisht asnjëse;
- 8.2 Numri minimal i mbledhjeve të Këshillit të Investimeve është jo më pak se 6 (gjashtë) të tilla brenda një viti. Datat dhe shpeshtësia e takimeve do të sugjerohen nga Sekretariati në bashkëpunim me Kryetarin dhe së fundmi miratohen nga anëtarët e KI gjatë takimeve të KI;
- 8.3 Me kërkesë të Kryetarit apo të çdo anëtari permanent të KI, mund të caktohen seanca të posaçme, në varësi të axhendës dhe/apo nevojës për të diskutuar tema konkrete të dala rishtaz.
- 8.4 Proçesi i konsultimit për përcaktimin e axhendës së Këshillit të Investimeve është thelbësor për efektivitetin e punës së këtij Këshilli, për të garantuar që pikat që do të diskutohen në çdo mbledhje të formulohen mirë, të analizohen dhe të arrijnë efektin maksimal.
- 8.5 Axhenda e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve përgatitet nga Sekretariati i KI në konsultim me Kryetarin e KI sipas kritereve të mëposhtme:
  - a) *Afatet e konsultimit* - Axhenda dhe materialet për secilin takim do t'u njoftohet anëtarëve të Këshillit të Investimeve për konsultim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes për konsultim;

- b) Burimi i identifikimi te temave - do të bazohet në propozimet e marra nga:
- i. sektori privat (komente të mbërritura pranë zyrës së Sekretariatit nga takime konsultative me ekspertët e Sekretariatit apo faqes së internetit të Këshillit të Investimeve);
  - ii. anëtarët e Këshillit të Investimeve;
  - iii. raportet e institucioneve ndërkombëtare mbi klimën e investimeve.
- c) Aprovimi i Axhendës - Këshilli i Investimeve në mbledhjen e radhës miraton axhendën për mbledhjen pasardhëse. Me kërkesë të Sekretariatit dhe kur më shumë se gjysma e anëtarëve dëshirojnë të shtojnë një pikë tjetër jashtë rendit të ditës të përcaktuar në axhendë, ajo shtohet menjëherë në rendin e ditës për objekt diskutimi.
- d) Transparenca e hartimit të draft-axhendës do të jetë objekt i një procesi të gjerë konsultimi në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e Këshillit, si dhe me palë të tjera të interesuara. Për këtë qëllim, Sekretariati i Këshillit të Investimeve do të krijojë dhe do të mirëmbajë në faqen e internetit një formular elektronik që t'i mundësojë publikut dhe të gjitha subjekteve të interesuara propozimin e pikave për axhendën e Këshillit të Investimeve;

#### ***Neni 9***

#### ***Proçedura e Zhvillimit të Mbledhjes***

- 9.1 Mbledhjet e Këshillit të Investimeve çelen kur të paktën në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
- 9.2 Vendimet merren me votim të hapur dhe me shumicën e numrit të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 9.3 Në rast se nuk sigurohet shumica e votave, vota e kryetarit është vendimtare në marrjen e vendimit.

### **KAPITULLI III BURIMET E FINANCIMIT**

#### ***Neni 10***

#### ***Burimet e financimit***

Financimi i Sekretariatit do të sigurohet nga BERZH me anë të mbështetjes së donatorëve të bankës për tre vitet e para. Më pas BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë do të shqyrtojnë efikasitetin e punës së Këshillit të Investimeve dhe do të vlerësojnë opsionet për rinovim të financim, duke përfshirë edhe komunitetin e biznesit.

***Neni 11***  
***Përdorimi i Fondeve***

- 11.1 Financimi që KI merr nga burimet e ndryshme, përdoret në përputhje me procedurat e paravendosura nga donatori/ët përkatës dhe vetëm për kryerjen e veprimtarive të KI sipas kuadrit ligjor në fuqi.
- 11.2 Donatorët e huaj ose vendas të cilët kontribuojnë me fonde financiare, kanë të drejtë të informohen nga KI, mbi rezultatet e përdorimit të këtyre fondeve.

**KAPITULLI IV**  
**STRUKTURA ORGANIZATIVE E KI**

***Neni 12***  
***Organet e KI***

Organet e KI janë:

- Kryetari i KI
- Sekretariati i KI

***Neni 13***  
***Anëtarësia e Këshillit të Investimeve***

Këshilli i Investimeve kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Këshilli përbëhet nga përfaqësues me status të përhershëm dhe anëtarë me status jo permanent.

- a) Anëtarë me status të përhershëm nga Këshilli i Ministrave dhe institucione në varësi:
- Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;
  - Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
  - Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Nxitjes së Investimeve (AIDA);
  - Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
  - Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- b) Anëtarë me status të përhershëm nga institucionet e pavarura kushtetuese:
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.
- c) Anëtarë me status të përhershëm nga institucione ndërkombëtare për zhvillim:
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
  - Bashkimi Evropian;
  - Banka Botërore/Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC).
- d) Anëtarë me status jo permanent nga biznesi :
- tre kompani;

- tre shoqata biznesi;
- e) Pjesëmarrja e anëtarëve me mandat jo të përhershëm organizohet nga Sekretariati. Këshilli i Investimeve miraton çdo gjashtëmuajor një axhendë të re duke zgjedhur anëtarë të rinj me status jo të përhershëm nga përfaqësues të biznesit. Kjo realizohet bazuar në një proces transparent që fillon me një rekomandim të Kreut të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve drejtuar Kryetarit të Këshillit. Ky rekomandim duhet të jetë rezultat i konsultimeve me anëtarët e përhershëm dhe komunitetin e biznesit.
- f) Nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretariatit, çdo anëtar i Këshillit të Investimeve mund të kërkojë pjesëmarrjen e palëve të tjera, si për shembull institucioneve publike shoqërive apo përfaqësuesve të shoqërisë civile, për çdo pikë të axhendës së Këshillit të Investimeve.
- g) Anëtarët me status të përhershëm dhe me status jo permanent si dhe palët e tjera që marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Investimeve nuk janë subjekt i shpërblimeve apo honorareve të çfarëdo lloji lidhur me veprimtarinë e tyre në Këshillin e Investimeve.

#### ***Neni 14***

#### ***Të Drejtat dhe Detyrat e Anëtarëve të Këshillit të Investimeve***

- 14.1 Anëtarët e Këshillit të Investimeve kanë të drejtë:
- a) Të marrin pjesë personalisht dhe në mënyrë aktive në mbledhjet e KI;
  - b) Të bëjnë propozime, të ndërhyjnë, të bëjnë vërejtje dhe të propozojnë ndryshime për pikat që diskutohen nga Këshilli i Investimeve;
  - c) Të marrin pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e rekomandimeve të diskutuara dhe/ose të miratuara nga Këshilli;
  - d) Të marrin në kohën e duhur të gjithë informacionin përkatës për pikat e diskutuara nga Këshilli i Investimeve;
  - e) Të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë aktivisht në seancat e organeve të punës së Këshillit të Investimeve;
  - f) Të votojnë lirisht për çdo pikë në axhendën e Këshillit të Investimeve;
  - g) Të kërkojnë informacion për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Këshilli i Investimeve;
  - h) Të marrin në konsideratë interesat e komunitetit të biznesit duke vepruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në mbledhjet e Këshillit të Investimeve;
  - i) Të nxisin zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Investimeve;
- 14.2 Anëtarët e Këshillit të Investimeve kanë detyrim të respektojnë Kodin e Etikës në mbledhjet e Këshillit të Investimeve.

#### ***Neni 15***

#### ***Kompetencat e Kryetarit të Këshillit të Investimeve***

Kryetari i Këshillit të Investimeve:

- Miraton datën dhe orën e mbledhjes së ardhshme të KI;
- Miraton axhendën e propozuar për çdo mbledhje të KI, bazuar në propozimet e marra nga Kreu i Sekretariatit;
- Adreson rekomandimet e Këshillit të Investimeve te Kryeministri, Ministri/Ministritë e linjës dhe Kuvendi si edhe u raporton anëtarëve të Këshillit të Investimeve komentet dhe sugjerimet e marra nga këto konsultime;
- Drejton mbledhjet e Këshillit të Investimeve dhe garanton që këto mbledhje të kryhen në mënyrë efikase, konstruktive dhe kolegjiale.

### ***Neni 16*** ***Funksionet e Sekretariatit të KI***

Sekretariati i Këshillit të Investimeve është një strukturë teknike dhe ekzekutive e pavarur e krijuar në përputhje me VKM nr. 294 datë 08.04.2015 dhe Memorandumin e Mirëkuptimit nënshkruar midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Funksionet kryesore të tij përfshijnë por pa u kufizuar në to janë si më poshtë:

- a) Në koordinim të ngushtë me anëtarët e Këshillit të Investimeve, harton dhe i propozon Kryetarit të Këshillit të Investimeve listën e kandidatëve për anëtarët me mandat jo permanent të Këshillit të Investimeve;
- b) I propozon Këshillit të Investimeve axhendën e mbledhjes së ardhshme të tij, mbi bazën e propozimeve nga anëtarët e Këshillit të Investimeve, si dhe të propozimeve nga komuniteti i biznesit;
- c) Të përgatisë në diskrecion të tij axhendën e ardhshme mundësisht për një periudhë gjashtëmujore. Temat për këtë axhendë do të shërbejnë si referencë kryesore për axhendën periodike të takimeve dhe për përzgjedhjen e anëtarëve jo të përhershëm sipas paragrafëve të mësipërm a) dhe b).
- d) Organizon mbledhjet e Këshillit të Investimeve dhe fton në mbledhjet e tij palët e treta të miratuara në bashkëpunim me Kryetarin;
- e) Në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit të Investimeve miraton axhendën e mbledhjes së ardhshme të KI dhe u shpërndan anëtarëve të Këshillit dhe të ftuarve materialet që do të diskutohen në atë mbledhje jo më vonë se 15 ditë përpara mbledhjes;
- f) Koordinon veprimtaritë e Këshillit të Investimeve me Ministrat përkatës, planifikon takime konsultimi me biznesin lidhur me propozimet e tyre që do të jenë objekt i diskutimeve në mbledhjet e KI, si edhe organizon sesione trajnimi teknik dhe profesional;
- g) Asiston KI në diskutimin dhe rishikimin e çështjeve specifike sektoriale, të procedurave ligjore dhe administrative, të cilat janë sjellë në Sekretariat, informon KI për propozimet përkatëse të marra lidhur me pikat e propozuara për axhendën e ardhshme të Këshillit të Investimeve, si dhe për ankesat specifike të marra nga biznesi për praktika të padrejta dhe diskriminuese;



- h) Organizon kërkime dhe analiza ekonomike që lidhen me fushën e veprimtarive të Këshillit të Investimeve dhe i raporton Këshillit gjetjet e tyre;
- i) Përgatit procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve dhe ia shpërndan atë anëtarëve të Këshillit për miratim brenda 5 ditëve nga mbledhja përkatëse;
- j) Mbështet dhe monitoron zbatimin e propozimeve të Këshillit të Investimeve, vlerëson rezultatet dhe ndikimin e propozimeve të zbatuara për cilësinë e klimës së investimeve dhe i raporton KI vlerësimet e tij;
- k) U raporton anëtarëve të Këshillit të Investimeve dhe palëve të tjera të interesuara për progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Investimeve;
- l) Informon publikun për veprimtaritë e KI, duke përdorur kryesisht faqen e internetit të KI, si një pikë informimi të aksesueshme;
- m) Harton, mbështet dhe kur është e nevojshme, ndryshon rregullat proceduriale të nevojshme për funksionimin efikas të Këshillit të Investimeve dhe të Sekretariatit të tij;
- n) Përgatit në mënyrë të pavarur strukturën e tij organizative dhe kompetencat e stafit të tij.
- o) Stafi i Sekretariatit rekrutohet nëpërmjet procedurave transparente, të hapura dhe konkurruese nën monitorimin dhe miratimin e BERZH-i, ose nga donatorët e tjerë që do të kontribuojnë për funksionimin e Sekretariatit, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare;
- p) Sekretariati është përgjegjës për mbajtjen e lidhjeve me komunitetin e biznesit, me shoqatat e biznesit, donatorët, organizatat ndërkombëtare, me përfaqësuesit e ambasadave të huaja dhe çdo institucion tjetër kombëtar apo ndërkombëtar.

### *Neni 17*

#### *Përbërja dhe Detyrat e Stafit të Sekretariatit të KI*

17.1 Sekretariati i KI përbëhet nga punonjës me kohë të plotë dhe ka minimalisht këtë përbërje:

- a) Drejtorin e Sekretarit të KI
- b) Asistentin Administrativ
- c) 1 (një) Ekspert Ligjor
- d) 1 (një) Ekspert Ekonomik

Ekspertë me afat të shkurtër (shqiptar apo të huaj) sipas nevojave të punës dhe fondeve të disponueshme.

17.2 Funksionet e Drejtorit të Sekretariatit të KI:

- a) Drejton dhe koordinon punën e Sekretariatit;

- b) Përgatit raportet dhe informacionet e nevojshme për Kryetarin, anëtarët e KI si edhe donatorët;
- c) Identifikon problematikën që do të bëhet objekt i axhendës së KI dhe ja propozon Kryetarit;
- d) Drejton dhe monitoron punën e komisioneve të këshillimit;
- e) Udhëheq punën për zhvillimin e termave të referencës dhe përgatitjen e analizave në përputhje me nevojat dhe rekomandimet e KI;
- f) Shërben si pikë e kontaktit midis anëtarëve të KI dhe donatorëve që janë financues të KI;
- g) Raporton tek BERZH në lidhje me punën dhe detyrat e Sekretariatit të KI;
- h) Informon në mënyrë të vazhdueshme Kryetarin e Keshillit në lidhje me problematikën e evidentuara nga takimet me biznesin;
- i) Përfaqëson Sekretariatit në marrëdhënie me anëtarët e KI;
- j) Për përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tij operacionale dhe me natyrë administrimi, me miratimin e BERZH përfaqëson Sekretariatit në marrëdhëniet me palët e treta.

#### 17.3 Funkcionet e Asistentit Administrativ:

- a) Përgatit anën logjistike për organizimin e mbledhjeve të KI;
- b) Mban dhe arkivon procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të KI;
- c) Mban dokumentacionin shkresor dhe të gjithë korrespondencën zyrtare të KI;
- d) Administron fondet financiare të KI sipas procedurave të financuesit të Sekretariatit.

#### 17.4 Funkcionet e Ekspertëve Teknikë:

- a) Identifikojnë dhe analizojnë pengesat kryesore në mjedisin e biznesit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në fushën e investimeve për t'u propozuar për konsultim në KI;
- b) Shqyrtojnë dhe vlerësojnë legjislacionin në fushën e sektorit privat duke shtruar rekomandime praktike në lidhje me reformat në fushën e klimës së biznesit, dhe reforma institucionale që ndikojnë në përmirësimin e investimeve të huaja dhe vendase.
- c) Hartojnë analiza, studime, dokumenta në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare në fushën e anti-korrupsionit në sektorin publik dhe atë privat si edhe sugjerojnë zgjidhje praktike për uljen e informalitetit në ekonomi;
- d) Paraqesin propozime lidhur me përgatitjen e axhendës dhe materialeve të tjera për t'u diskutuar në mbledhjet e KI;
- e) Asistojnë dhe koordinojnë përpjekjet me Drejtorin e Sekretariatit për të përmbushur të gjitha funksionet e Sekretariatit të Investimeve sipas kësaj Rregulloreje dhe sipas VKM nr. 294 datë 08.04.2015.

## ***Neni 18*** ***Komunikimi***

- 18.1 Këshilli i Investimeve përdor një format të miratuar me siglën e tij për komunikimin zyrtar, një logo dhe një vulë të tijën.
- 18.2 I gjithë komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë të shkruar për t'u pranuar si dokument i ligjshëm në lidhje me këtë rregullore.
- 18.3 Si pjesë të transparencës, Sekretariati zhvillon dhe menaxhon faqen e internetit të Këshillit të Investimeve, krijon broshura informuese periodike që kanë si synim informimin e publikut për punën e kryer nga Këshilli i Investimeve.

## ***Neni 19*** ***Rregullat për Mbledhje Efektive të Këshillit të Investimeve***

Standardet për Sekretariatën e Këshillit të Investimeve kur harton draft-axhendën e Këshillit:

- a) Axhenda shërben për informimin paraprak të pjesëmarrësve për pikat që do të diskutohen, në mënyrë që ata të mund të përgatiten dhe informohen, dhe të jenë gati për të kontribuar me ide dhe për të shtruar pyetje;
- b) Vendos rendin e diskutimit të pikave të propozuara – më e mira është të diskutohen në fillim pikat e rëndësishme, për të siguruar kohën e mjaftueshme për përfundimin e diskutimeve;
- c) Në mbledhjet e rregullta, pika e fundit e axhendës duhet të jetë “Data e mbledhjes së ardhshme”.
- d) Është me vlerë që çështjet të merren në konsideratë sipas sektorit dhe të mos merren në konsideratë vetëm ato që lidhen me disa biznese, të cilat nuk kanë asnjë ndikim apo kanë ndikim shumë të vogël në sektor apo në klimën e biznesit si një e tërë.

## ***Neni 20*** ***Krijimi dhe Funkcionet e Komisioneve të Këshillimit***

- 20.1 Komisionet e këshillimit krijohen mbi baza të posaçme, me sugjerim të KI ose të anëtarëve të tij. Ato mund të kenë në përbërje të tyre përfaqësues nga shoqatat e biznesit, agjencitë publike, konsulentë teknike dhe grupe të tjera të interesit.
- 20.2 Komisionet drejtohen nga Sekretariati i KI.
- 20.3 Komisioni i Këshillimit krijohet për të:
  - a) Mundësuar pjesëmarrje sa më të gjërë të palëve të interesuara në përbërje të grupeve të punës;
  - b) Siguron informacion nga anëtarësia e shoqatave të biznesit, grupet e interesit dhe nga institucionet publike;
  - c) Organizon diskutime teknike për të kërkuar mendime për çështjet që trajton;

- d) Përgatit dhe paraqet për miratim në KI, studimet, raportet dhe konkluzionet e punës për të cilin është krijuar.

## **KAPITULLI V**

### **PUBLIKIMET E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE**

#### *Neni 21* *Raporti vjetor i KI-së*

Raporti vjetor përmban por pa u kufizuar:

1. Misionin dhe objektivat vjetore të KI;
2. Përbërjen e anëtarëve për atë vit kalendarik;
3. Çështjet dhe temat e shqyrtuara nga KI;
4. Komisionet e Këshillimit, përbërja dhe rekomandimet e tyre;
5. Rekomandimet e adresuara në qeveri dhe komisionet parlamentare;
6. Ndikimi i këtyre rekomandimeve në ndryshimin e legjislacionit

#### *Neni 22* *Vlefshmëria e Rregullores*

- 22.1 Rregullorja hyn në fuqi pas diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e parë të KI. Vendimi për miratim merret me shumicën e thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 22.2 Rregullorja i bëhet e njohur të gjithë organizatave të biznesit, institucioneve të administratës publike, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë.

*Tiranë, më 1 Korrik 2015*